



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.2774/13 Prot.

Datë 16.01.2024

**V E N D I M**  
**Nr. 58/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.01.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

**Objekt:**

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1246/2023, datë 05.12.2023 për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 15 muaj me nr. REF-80371-09-18-2023 me objekt: “*Blerje inerte*”, me fond limit 130.829.660 (*njëqind e tridhjetë milion e tetëqind e njëzet e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë*) lekë pa TVSH. Vlera e fondit limit në monedhën ndërkombëtare euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është 1.229.718 (*një milion e dyqind e njëzet e nëntë mijë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë*) euro pa TVSH. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë për monedhën euro në datë 18.09.2023 është 106,39, zhvilluar me datë 19.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik.

**Ankimues:**

Operatori Ekonomik “*Shpresa-AL*” SHPK me NIPT K31321021N dhe adresë: rruga “*Urani Pano*”, mbrapa “*Veve Center*”, Pall nr. 11, Kati. 2, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:**

Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik  
Adresë: Rruga “*5 Maj*”, Tiranë.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

**Vëren:****I****Rrethanat e çështjes**

I.1. Në datën 15.12.2023, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1246/2023, ku vendosi:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Shpresa AI” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”, Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 15 muaj me nr. REF-80371-09-18-2023 me objekt: “Blerje inerte”, me fond limit 130.829.660 (njëqind e tridhjetë milion e tetëqind e njëzet e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH. Vlera e fondit limit në monedhën ndërkombëtare euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është 1.229.718 (një milion e dyqind e njëzet e nëntë mijë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë) euro pa TVSH. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë për monedhën euro në datë 18.09.2023 është 106,39, zhvilluar me datë 19.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysht konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Shpresa AI” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 2747/19 prot., datë 10.01.2024, protokolluar me tonën nr. 2774/10 prot., datë 16.01.2024, autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik., informon se: “[...] Në zbatim të vendimit me Nr. 2774/7 prot, datë 05.12.2023, protokolluar me tonën me nr. 2447/15 prot, datë 13.12.2023, ju bëjmë me dije se: Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë, në datën 19.10.2023 ora 09:00 ka zhvilluar procedurën e prokurimit “E hapur”, me numër reference REF-80371-09-18-2023, me objekt “Blerje Inertesh” dhe fond limit 130.829.660 (njëqind e tridhjetë milion e tetëqind e njëzet e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa tvsh. Në datën 18.02.2023 pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik është protokolluar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik me Nr. 2774/7, datë 05.12.2023, protokolluar me tonën me Nr. 2747/15 Prot, datë 13.12.2023. Autoriteti Kontraktor në datën 18.12.2023, me anë të “Urdhërit Për Anullimin e Procedurës së Prokurimit nr. 2747/18 prot., datë 18.12.2023 ka bërë anulimin e procedurës me nr. REF-80371-09-18-2023, me objekt “Blerje Inertesh” dhe fond limit 130.829.660 (njëqind e tridhjetë milion e tetëqind e njëzet e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa tvsh në zbatim Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik me Nr. 2774/7, datë 05.12.2023, protokolluar me tonën me Nr. 2747/15 prot, datë 13.12.2023”. Komisioni i Prokurimit Publik, bëri verifikimet përkatëse në sistemin e prokurimeve elektronike të Agjencisë së Prokurimit Publik, lidhur me zbatimin e vendimit K.P.P 1246/2023, datë 05.12.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”, Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 15 mujor me nr. REF-80371-09-18-2023 me objekt: “Blerje inerte”, me fond limit 130.829.660 (njëqind e tridhjetë milion e tetëqind e njëzet e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH. Vlera e fondit limit në monedhën ndërkombëtare euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është 1.229.718 (një milion e dyqind e njëzet e nëntë mijë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë) euro pa TVSH. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë për monedhën euro në datë 18.09.2023 është 106,39, zhvilluar me datë 19.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik. Nga ky verifikim, rezultoi, se autoriteti kontraktor ka anuluar në SPE procedurën e mësipërme të prokurimit në përputhje me përcaktimet në vendimin K.P.P 1246/2023, datë 05.12.2023. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor, nëse do të ripublikojë procedurën e prokurimit objekt-ankimi duhet të ketë në konsideratë në momentin e hartimit të dokumenteve të reja të tenderit, përcaktimet e bëra në vendimin KPP 1246/2023, datë 05.12.2023, si dhe të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik.

## II

### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

### **Arsyeton**

II.1. Me shkresën nr. 2747/19 prot., datë 10.01.2024, protokolluar me tonën nr. 2774/10 prot., datë 16.01.2024, autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik., informon se: “[...] Në zbatim të vendimit me Nr. 2774/7 prot, datë 05.12.2023, protokolluar me tonën me nr. 2447/15 prot, datë 13.12.2023, ju bëjmë me dije se: Drejtoria e

*Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë, në datën 19.10.2023 ora 09:00 ka zhvilluar procedurën e prokurimit “E hapur”, me numër reference REF-80371-09-18-2023, me objekt “Blerje Inertesh” dhe fond limit 130.829.660 (njëqind e tridhjetë milion e tetëqind e njëzet e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa tvsh. Në datën 18.02.2023 pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik është protokolluar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik me Nr. 2774/7, datë 05.12.2023, protokolluar me tonën me Nr. 2747/15 Prot, datë 13.12.2023. Autoriteti Kontraktor në datën 18.12.2023, me anë të “Urdhërit Për Anullimin e Procedurës së Prokurimit nr. 2747/18 prot., datë 18.12.2023 ka bërë anullimin e procedurës me nr. REF-80371-09-18-2023, me objekt “Blerje Inertesh” dhe fond limit 130.829.660 (njëqind e tridhjetë milion e tetëqind e njëzet e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa tvsh në zbatim Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik me Nr. 2774/7, datë 05.12.2023, protokolluar me tonën me Nr. 2747/15 prot, datë 13.12.2023”. Komisioni i Prokurimit Publik, bëri verifikimet përkatëse në sistemin e prokurimeve elektronike të Agjencisë së Prokurimit Publik, lidhur me zbatimin e vendimit K.P.P 1246/2023, datë 05.12.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”, Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 15 muaj me nr. REF-80371-09-18-2023 me objekt: “Blerje inerte”, me fond limit 130.829.660 (njëqind e tridhjetë milion e tetëqind e njëzet e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH. Vlera e fondit limit në monedhën ndërkombëtare euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është 1.229.718 (një milion e dyqind e njëzet e nëntë mijë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë) euro pa TVSH. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë për monedhën euro në datë 18.09.2023 është 106,39, zhvilluar me datë 19.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik. Nga ky verifikim, rezultoi, se autoriteti kontraktor ka anuluar në SPE procedurën e mësipërme të prokurimit në përputhje me përcaktimet në vendimin K.P.P 1246/2023, datë 05.12.2023. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor, nëse do të ripublikojë procedurën e prokurimit objekt-ankimi duhet të ketë në konsideratë në momentin e hartimit të dokumenteve të reja të tenderit, përcaktimet e bëra në vendimin KPP 1246/2023, datë 05.12.2023, si dhe të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik.*

II.2. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dokumentacionit bashkëlidhur saj, si dhe nga verifikimi në sistemin e prokurimeve elektronike të Agjencisë së Prokurimit Publik, konstatohet, se autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin KPP 1246/2023, duke anuluar në SPE procedurën e mësipërme të prokurimit.

Autoriteti kontraktor duhet të ketë në konsideratë, se me rihedhjen e procedurës në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, duhet të dërgoje pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dokumentacionin e tenderit, me reflektimet përkatëse sipas përcaktimeve të bëra në vendimin KPP 1246/2023 datë 05.12.2023.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik i ndryshuar”, nenit 45 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik

Nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”, Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 15 mujor me nr. REF-80371-09-18-2023 me objekt: “Blerje inerte”, me fond limit 130.829.660 (njëqind e tridhjetë milion e tetëqind e njëzet e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH. Vlera e fondit limit në monedhën ndërkombëtare euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është 1.229.718 (një milion e dyqind e njëzet e nëntë mijë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë) euro pa TVSH. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë për monedhën euro në datë 18.09.2023 është 106,39, zhvilluar me datë 19.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Krugëve dhe Ndriçimit Publik.
2. Autoriteti Kontraktor me ripublikimin e procedurës së prokurimit, të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik dokumentet standarde të tenderit (DST) të firmosura dhe të vulosura, ku të jenë pasqyruar reflektimet përkatëse të bëra në vendimin 1246/2023 të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

